

<b>Të dhënat kryesore për lëndën</b>	
Njësia akademike	Fakulteti Filozofik
Lënda	Histori Bashkëkohore Shqiptare I
Niveli	Ba
Statusi lëndës	Obligative
Viti i studimeve	III, Semestri Dimëror
Numri i orëve në javë	3+2
Vlera në kredi – ECTS	7
Koha / lokacioni	
Mësimdhënësi i lëndës	Prof. Asoc.Dr. Selim Bezeraj
Kontakti	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë mbulon zhvillimet kryesore politike, diplomatike, ekonomike, kulturore dhe sociale tek shqiptarët Brenda viteve 1912-1943.
Qëllimet e lëndës	Përmes kësaj lënde studentët pajisen me njohuritë themelore dhe fillojnë të reflektojnë lidhur me përkufizimin “Histori Bashkëkohore Shqiptare”, në rastin konkret të asaj shqiptare; për proceset kryesore historike brenda këtij përkufizimi; për rolin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në themelimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe funksionalizimin e tij, si dhe në përpjekjet e shqiptarëve për zgjedhjen e çështjes kombëtare në frymën e rrethanave politike dhe juridike të kohës; Studentët marrin njohuri dhe për pozitën dhe trajtimin e shqiptarëve në kuadër të shteteve fqinje si dhe për përpjekjet e tyre për të drejtat e tyre qytetare e kombëtare, për pozitën dhe orientimin e shqiptarëve në kuadër të skemave politike dhe ushtarake (luftërat rajonale dhe botërore) të imponuara nga jashtë – Fuqitë e Mëdha; po kështu studentët pajisen me njohje bazike për zhvillimet ekonomike, kulturore dhe sociale në përgjithësi për botën shqiptare, duke u fokusuar në periudhat më dinamike të këtyre zhvillimeve si dhe për literaturën dhe burimet historiografike të cilat pasqyrojnë këto zhvillime.
Rezultatet e pritura të nxënies	Studentët duhet të dijnë përse kjo periudhë historike përkufizohet si histori bashkëkohore shqiptare; Të definojnë rolin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në themelimin dhe funksionalizimin e shtetit shqiptar si dhe në zgjedhjen e çështjes kombëtare shqiptare;

	Të kuptojnë rolin interferues të fenomeneve ekonomike, kulturore, sociale dhe politike në proceset kryesore historike në botën shqiptare të kësaj periudhe; Të krahasojnë pozitën e shqiptarëve në shtetet fqinje me etnitetet tjera atje, si dhe në relacionin me rrethanat botërore lidhur me çështjen.		
<b>Ngarkesa e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.30	10 ditë/javë	5
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	4	2 ditë/javë	8
Detyra të shtëpisë	2	5 ditë	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	21 ditë/3 javë	42
Përgaditja përfundimtare për provim	2	7 ditë	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2 javë	4
Projektet, prezentimet ,etj	2	8 ditë	16
<b>Totali</b>			<b>174:25=7 ECTS</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies</b>	Kursi për këtë lëndë do të zhvillohet përmes ligjëratave, analizës së burimeve të kohës, diskutimeve rreth temave të shtruar, eseve, seminareve dhe formave tjera të preferuara dhe të propozuara nga studentët.		
<b>Metodat e vlerësimit</b>	Vlerësimi messemestral:	20%	
	Seminari dhe prezantimi	30%	
	Vijimi i rregullt	10%	
	Vlerësimi përfundimtar:	40%	
	<b>Totali</b>	<b>100%</b>	
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë</b>	Valenina Duka, Histori e Shqipërisë 1912-2000, Tiranë: Shblu, 2007. Kristaq Prifti, et.AL., Historia e Popullit Shqiptar III-IV, Tiranë 2007. Nina Smirnova, Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX, Tiranë: Phoenix, 2004.		

	<p>Noel Malcolm. Kosova, histori e shkurtër, Prishtinë: Koha, 2008.</p> <p>Arben Puto, Histori politike e Shqipërisë 1912-1939, Tiranë 2010.</p>
Literatura shtesë	<p>Limon Rushiti, Rrethanat shoqërore – politike në Kosovë 1912-1918, Prishtinë 1981;</p> <p>Selim Bezeraj, Shqiptarët dhe Austro-Hungaria gjatë viteve 1912-1914. Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2016</p> <p>Bernd Fischer, Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri, Tiranë: Çabej, 2004.</p> <p>Paskal Milo, Histori e Shqipërisë Vëllimi I, Tiranë: Toena, 2013.</p> <p>Milan Obradovic, Reforma Agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941), Prishtinë: Instituti i Historisë- Prishtinë, 2005.</p> <p>Miranda Vickers, Shqipëria-Një histori moderne, Nicola Guy, Lindja e Shqipërisë, Tiranë, 2012.</p> <p>Christian Lohr, Themelimi i Shqipërisë, 2019.</p> <p>Esilda Luku, Diplomacia evropiane ndaj Shqipërisë ndërmjet dy konferencave të paqes, Prishtinë, 2015.</p>

Plani mësimor	
Java	Ligjerata
<i>Java e parë</i>	Vështrim i përgjithshëm lidhur me lëndën-programin, literaturën si dhe për metodat e mësimin, Hyrje në ngjarjet pararendëse të periudhës që mbulon ky kurs
<i>Java e dytë</i>	Shqipëria dhe shqiptarët nga Kuvendi i Vlorës deri në Luftën e Parë Botërore
<i>Java e tretë</i>	Shqiptarët përgjatë LPB; Zonat e pushtimit; Lëvizja kombëtare shqiptare 1915-1918
<i>Java e katërtë</i>	Çështja Shqiptare në Konferencën e Parisit; Konsolidimi i pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë 1918-1921
<i>Java e pestë</i>	Kongresi Kombëtar i Lushnjës, Përpjekjet për Demokratizimin dhe Stabilitetin e Shtetit Shqiptar (1921-1923), Revolucioni i Qershorit i viti 1924
<i>Java e gjashtë</i>	Republika Shqiptare në vitet 1925-1928, Depërtimi ekonomik Italian në Shqipëri
<i>Java e shtatë</i>	Vendosja e regjimit monarkist, reformat e Mbretit Zog I, Politika e jashtme e Mbretërisë Shqiptare

<i>Java e tetë</i>	Vlerësim i parë intermediar
<i>Java e nëntë</i>	Zhvillimet arsimore dhe kulturore tek shqiptarët 1920-1939
<i>Java e dhjetë:</i>	Ripushtimi i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nga M. SKS: Reforma Agrare, kolonizimi, shpërngulja .
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Pushtimi i Shqipërisë prej Italisë, rezistenca antifashiste në Shqipëri
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Pushtimi i Jugosllavisë nga ana e Italisë, Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Zhvillimet arsimore dhe kulturore në Shqipërinë e bashkuar në kohën e pushtimit Italian
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Kapitullimi italian dhe pushtimi gjerman i trevave shqiptare
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Rezistenca e armatosur antifashiste, Legaliteti, Lëvizja Nacional Çlirimtare

### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

*Cakto politikat e mirësjelljes konform Statutit të UP*

- Ardhja me kohë në ligjërata dhe konsultime
- Sjellja korrekte dhe kolegjale
- Kopjimi me rastin e vlerësimeve intermediare dhe provimit final - i papranueshëm;
- Kontakti me profesorin dhe asistentin e lëndës lidhur me çështjet që dalin nga lënda përkatëse - nëpërmjet e-mail adresave.